

BULETINI TREMUJOR
FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS



TRUSTORJA

PERFORMANCA KUMULATIVE E FKPK-SË PREJ THEMELIMIT



PERIUDHA	1M	3M	VITI	1V	5V	NGA THEMELIMI
REZULTATI	-2.14%	-4.24%	-1.16%	0.58%	27.18%	27.29%
BENÇMARKU*	-0.39%	-0.47%	-0.79%	-1.25%	9.46%	30.27%

*INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT I PUBLIKUAR NGA AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

PERFORMANCA DHE KTHIMI NGA INVESTIMET NË TM3 2015

ÇMIMI I AKSIONIT:

KORRIK	▲ +1.69%
GUSHT	▼ -3.77%
SHTATOR	▼ -2.14%
GJITHSEJ PERFORMANCA NETO	▼ -4.24%


KTHIMI BRUTO:

KORRIK	+20.36 mln
GUSHT	-45.33 mln
SHTATOR	-24.70 mln
GJITHSEJ KTHIMI BRUTO	-49.67 mln

FAKTET KRYESORE

ÇMIMI I AKSIONIT €1.2729	MJETET NETO NËN MENAXHIM €1,157,576,162.63
PENSIONE TË SHPAGUARA KËTË TREMUJOR €3.17 mln	PENSIONE TË SHPAGUARA KËTË VIT €14.23 mln
LLOGARI TË PENSIONUARA KËTË TREMUJOR 1,393	LLOGARI TË PENSIONUARA KËTË VIT 3,856
LLOGARI TË KONTRIBUESVE 498,805	LLOGARI AKTIVE KËTË VIT 280,859
KONTRIBUES TË RINJ 9,006	KONTRIBUTE KËTË TREMUJOR €34.86 mln
SHËRBIME TË OFRUARA KËTË TREMUJOR 34,813	GJITHSEJ LLOGARI TË AKTIVIZUARA NË eTRUSTI 45,082

ALOKIMI I MJETEVE NË FUND TË TREMUJORIT



€-12.16 MLN KTHIMI BRUTO PËR VITIN AKTUAL

Tremujori i tretë përfundoi me një performancë negative prej -4.24% duke ndikuar që edhe performanca për vitin aktual të kalojë në territor negativ, prej -1.16%. Kjo performancë bëri që në fund të TM3 çmimi i aksionit të ulet në 1.2729 euro (TM2: 1.3293 euro). Performanca tejet pozitive e investimeve në TM1 ndikoi në ekuilibrin vjetor të kthimit nga investimet, duke mbajtur reale mundësitë që gjatë TM4 performanca vjetore e FKPK-së të jetë përsëri në zonë pozitive. Në anën tjetër, mjetet nën menaxhim u kurrën gjatë TM3 me rreth €2.3 mln, duke rënë në rreth €1.16 miliardë. Ndërsa kontributet e reja për këtë periudhë ishin €34.9 mln. Gjatë TM3 u shpague për pension €3.2 mln, u mbajtën për tarifat menaxhuese (investuese dhe operacionale) €1.4 mln dhe u rifunduan €0.8 mln.

FAKTORËT ME NDIKIM

Tregjet financiare globale njohën oscilime të forta gjatë TM3, me një rënie të fortë të nxitur nga dobësimi përtej parashikimeve të treguesve ekonomikë në Kinë. Kjo solli frikë tek sipërmarrësit për konsumin dhe eksportet e ekonomisë më të madhe në zhvillim, dhe si pasojë ndodhi një shitje masive e aksioneve, sidomos në bursat aziatike. Këtë gjendje e rëndoi tutje edhe vendimi i qeverisë kineze për të kontrolluar zhvlerësimin e Juan-it kundrejt monedhave të tjera, me çka edhe dëmtoheshin një numër ekuilibrash ekonomikë të vendosur mbi bazën e ofertë-kërkesës. Veç këtyre, as vendimi i FED-it për të mos ndërprerë politikën e lehtësirave monetare në shtator nuk i erdhi në ndihmë tregjeve, të cilat e përkthyen këtë si reflektim i gjendjes jo të mirë të treguesve ekonomikë në SHBA dhe vendeve në zhvillim.

PERFORMANCA E FONDEVE INVESTUESE

Fondet investuese të FKPK-së shfaqën shenja pozitive të amortizimit të oscilimeve të forta në tregje kundrejt portofolit të përgjithshëm të FKPK-së. Për ilustrim të kësaj: indeksi S&P 500 ra gjatë TM3 -6.94% ndërsa çmimi i njësisë së FKPK-së ra me -4.24%. Analizuar gjitha fondet investuese të angazhuara nga FKPK, vetëm fondi i Nordea SRF qëndroi në kuota pozitive (+0.30%), pasi ka portofol të diversifikuar në instrumente dhe të përqendruar në monedhën euro (77.5%), që e favorizoi këtë tremujor. Ndërsa të gjitha fondet e tjera ishin në territor negativ. Fondet e përqendruara në aksione, sikurse edhe pritet, ishin me rënie më të madhe, megjithatë edhe këtu kishte dallime. Fondi i KBI DP (-9.94%), i Tobam (-9.76%), dhe i Pictet (-8.98%), të ndikuara nga faktorët e shpërndarjes gjeografike të investimeve (si Azi e Evropë), por edhe nga shpërndarja sektoriale (industri financiare, minerare, energjetikë dhe produkte konsumi) performuan më keq. Fondet e tjera të pastra në aksione: si Vanguard (-7.85%) dhe Nordea GSEF (-5.04%), ishin diçka më mirë për shkak të përqendrimit të investimeve në SHBA. Ndërsa fondi i përzier i AXA-WFOI (-5.30%) dhe i BNY Mellon (-1.68%) shmangen rëniet nga prezenca në fond e instrumenteve të tjera financiare (kryesisht bonove). Fondi i pastër në bono i Schrodgers (-2.35%) nuk përfitoi edhe aq, pasi lehtësirat monetare në SHBA nuk e favorizojnë këtë fond, ndërsa portofoli i AXA GILB (-0.08%), me 48% të portofolit në USD nuk përfitoi nga vlerësimi i kësaj monedhe. Investimet në Kosovë (bono të qeverisë) janë me afat të paracaktuar maturimi, dhe kthimi nga këto investime për TM3 ishte 0.59%.

KTHIMI NGA INVESTIMET NË TM3

-4.24%

KTHIMI NGA INVESTIMET PËR VITIN

-1.16%

PLASMANET DHE PERFORMANCA PËR SECILIN MENAXHUES/EMETUES

MENAXHUESI/EMETUESI	EMRI I FONDIT/INSTRUMENTIT	PLASMANET	PERFORMANCA
Vanguard	Global Stock Index Fund - Euro	€328,148,160.29	-7.85%
BNY Mellon	Global Real Return Fund	€168,470,723.64	-1.68%
Schroders	Strategic Bond - Euro Hedged	€111,199,069.71	-2.35%
Nordea	1-Stable Return Fund	€142,431,999.20	+0.30%
AXA	Global Inflation Linked Bonds	€97,160,324.98	-0.08%
Thesari i Republikës së Kosovës	Obligacione dhe fletobligacione	€72,159,280.22	+0.59%
KBI	Divident Plus	€53,512,039.09	-9.94%
Nordea	1-Global Stable Equity Fund	€52,953,378.91	-5.04%
TOBAM	Anti-benchmark WEFE hedged share class	€33,146,826.41	-9.76%
Pictet	High dividend selection Z EUR	€30,294,462.38	-8.98%
AXA	WF Optimal Income I EUR	€26,933,384.47	-5.30%
GJITHSEJ		€1,134,533,594.70	-4.24%

BORDI ZHVILLOI DY MBLEDHJE

Bordi Drejtues i FKPK-së i ka zhvilluar dy mbledhje gjatë TM3: më 4 dhe 29 shtator. Mbledhjen e 4 shtatorit Bordi e zhvilloi të jashtëzakonshme për shkak të rënies së fortë në tregjet financiare, dhe ndikimit të saj në performancën investuese të FKPK-së. Por duke pasur parasysh faktin se strategjia aktuale investuese po i rezistonte mjaft mirë turbulencave në tregje, dhe parashikimeve se ekonomia globale nuk vlerësohet se ka probleme serioze makroekonomike, Bordi vendosi ta ruajë këtë strategji deri në mbledhjen e radhës në fund të shtatorit. Deri atëherë Bordi do të kërkonte nga të gjithë menaxhuesit e mjeteve të dërgojnë vlerësimet e tyre për performancën e fondeve investuese ku FKPK-ja ka alokuar mjete.

Në këtë mbledhje Bordi kishte marrë vendim që FKPK-ja të ofertojë 10 milionë euro në ankandin e 29 shtatorit të bonove 2-vjeçare të Kosovës.

Ndërsa në mbledhjen e 29 shtatorit Bordi Drejtues i mori këto vendime kryesore: të ndryshohen disa limite në strategjinë investuese, të miratohen tarifat për vitin 2016 për investime (0.398%) dhe për operacione (0.082%) dhe të njëjtat i dërgohen Kuvendit për miratim, të shpallet njoftimi për shprehje të interesit për të investuar mjete në depozitat bankare në Kosovë, dhe të publikohet shprehje e interesit për bankat që dëshirojnë ta ofrojnë tërheqjen me faza.

Në fund, pasi shqyrtoi dhe vlerësoi performancën e përgjithshme investuese të bazuar në strategjinë aktuale, dhe pasi kishte marrë raporte të detajuara nga menaxherët e fondeve investuese për parashikimet e performancës. Bordi Drejtues vlerësoi se nuk ka nevojë që në këtë moment të ndryshohet strategjia e investimeve, andaj edhe e ruajti të njëjtën.

LIGJI PËR FONDET PENSIONALE NË PROCES TË NDRYSHIMIT

Ligji aktual për Fondet Pensionale në Kosovës 04/L-101, dhe amandamenti i tij 04/L-168, janë në proces të rishikimit dhe plotësimit. Përfaqësues të FKPK-së janë pjesë e grupit punues, dhe nga informacionet deritanishme pritet që ndryshimet e plotësimet në Ligj të jenë kryesisht teknike, duke bërë qartësime në disa pika dhe përgjegjësi të caktuara, por nuk pritet të ndryshohet thelbi i mënyrës se si funksionon Shtylla II. Sidoqoftë, nuk është e pritshme që ndryshimet në Ligjin aktual do të mund të ndodhin brenda këtij viti.

SKADON MANDATI EDHE I PESË ANËTARËVE TË BORDIT

Pesë prej shtatë anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës u skadoi mandati në fund të muajit tetor, ndërsa një anëtar profesional i kishte skaduar mandati më 23 janar 2015. Komisioni Përzgjedhës ia ka dërguar Kuvendit të Kosovës emrat e kandidatëve për emërim për pesë pozita të përzgjedhur nga konkursi i hapur sipas kërkesave ligjore. Si rezultat Bordi Drejtues aktualisht ka në përbërje vetëm një anëtar me mandat.

Në ndërkohë është rishpallur konkursi për një anëtar profesional dhe në tetor lista e të gjithë kandidatëve i është dërguar Komisionit Përzgjedhës për vlerësim.

Me vetëm një anëtar me mandat, Bordi Drejtues nuk e ka kuorumin e nevojshëm (prej së paku pesë anëtarëve) për vendimmarrje, dhe si i tillë bëhet jofunksional, deri në emërimet nga Kuvendi i Kosovës. Duhet te theksohet se Bordi Drejtues ndër të tjera ka kompetenca ekskluzive për investimet dhe mbarëvajtjen e fondit pensional. Megjithëkëto, Bordi Drejtues ia ka deleguar disa kompetenca rreth çështjeve operacionale ditore anëtarit të ngelur në Bord dhe Menaxhmentit deri në emërimin e përbërjes së re të Bordit.

31% MË SHUMË SHËRBIME SE VITIN E SHKUAR

Numri i shërbimeve të ofruara nga zyra e FKPK-së për tremujorin shkoi në 19,427 (nga 19,398 në TM2), ose një rritje me 0.1%. Krahasuar me nëntëmujorin e një viti më parë numri i shërbimeve është shtuar për 31% në 57,505 (30.09.2014: 43,759).

Tri shërbimet më të kërkuara këtë tremujor ishin: shtypja e pasqyrave (36%), shtypja e njoftimeve për pensionim (32%), dhe hapja e llogarive në eTrusti (8%). Në anën tjetër numri i vetëshërbimeve përmes eTrustit ra më tutje në 1,322 (TM2: 1,930), ndërsa rënie patën edhe shërbimet në zyrat rajonale të ATK-së në 9,062 (TM2: 9,851).

Në total për TM3 u shërbyen ose vetshërbyen 29,811 kontribuues që përbënin 11.0% e kontribuuesve aktivë (TM2: 31,179 shërbime sa 12.0% e kontribuuesve aktivë), dhe kjo rënie erdhi nga më pak shërbime në ATK dhe më pak vetëshërbime në eTrusti.

€3.2 MLN PENSIONE TË SHPAGUARA NË TM3

Pensionet e shpaguara gjatë TM3 (prej €3.2 mln) pësuan tkurrje krahasuar me pensionet e shpaguara më TM2 (prej €5.5 mln). Vlera e përgjithshme e mjeteve të shpaguara për nëntëmujorin e këtij viti arriti kështu në rreth €14.2 mln. Për të njëjtën periudhë të një viti më parë (nëntëmujori 2014) kjo shumë ishte rreth €11 mln, ose për 29% më pak.

Krahasuar nëntëmujorin e këtij viti me të njëjtin e një viti më parë numri i kontribuuesve të pensionuar është rritur për 21% (nga 3,321 në 4,014). Për këtë nëntëmujor pensionime të moshës ishin 3,281 (ose 82%), raste të vdekjes ishin 573 (ose 14%) dhe të invaliditetit 160 (ose 4%).

Sa i përket bilancit mesatar të llogarive në fund të nëntëmujorit, për llogaritë aktive është rritur për 10% në €3,295 (30.09.2014: €2,846) ndërsa për të gjitha llogaritë ekzistuese është rritur për 8% në €2,117 (30.09.2014: €1,964).

BQK DËRGOI RAPORTIN FINAL TË INSPEKTIMIT

Banka Qendrore e Kosovës (BQK) gjatë TM3 ia ka dorëzuar FKPK-së raportin final të inspektimit të bërë për vitin 2014. Raporti nuk ka evidentuar të gjetura të natyrës serioze, që mund të kishin cenuar interesin e kontribuuesve, ose që mund të ishin brengosëse për ta. Në raport janë dhënë disa rekomanime për avancimin e proceseve në FKPK, të cilat pritet të implementohen gjatë këtij viti.

Në ndërkohë, BQK e ka miratuar auditorin e jashtëm të përzgjedhur nga FKPK-ja, Deloitte Kosova, për dy vjetët e ardhshëm. Pas miratimit nga BQK, FKPK-ja ka filluar shkëmbimin e informacioneve me kompaninë në fjalë, dhe gjatë TM4 pritet të fillojë procesi i auditimit. Opinioni final i auditorit të jashtëm rreth aktivitetit financiar të FKPK-së prezantohet në pasqyrat financiare për vitin 2015, që publikohen më së largu në prill 2016.

BOTUES:

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
Nëntor 2015

REDAKTOR:

Vërshim Hatipi

AUTOR:

Jeton Demi

KONTAKT:

Rr. "Agim Ramadani" Nr. 10,
10000 Prishtinë

038-244-341

info@trusti.org

www.trusti.org